



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.180/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AAK, dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit LDK-AKR dega në Gjilan, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,200.00 (*tremij e dyqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09 Qershor 2017 ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017, në rrugën qarkore (rrugë magjistrale që e lidh Gjilanin me Ferizajin) monitoruesit e tyre kan hasur në postera të kandidatëve për deputet të Kuvendit nga radhët e koalicionit LDK-AKR të ngjitura në transformator të energjisë elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara të lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë i datës 10.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se pas pranimit të ankesës, konform dispozitave ligjore i LZP-së kemi urdhëruar kandidatët që të ndërmarrin veprimet e duhura përmirësuese, veprime këto nga të cilat edhe janë evituar shkeljet e pretenduara ankimore. PZAP-it i ka kërkuar me rastin e shqyrtimit të ankesës mos ti shqiptojë gjorbë, pasi që efekti i ankesës është arritur me rastin e ndërmarrjes së masave përmirësuese. Si dëshmi ka bashkangjitur dy fotografi nga ku janë larguar posterat e kandidatit në fjalë, nga aty ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit LDK-AKR janë vendosur në vende të ndryshme pra të gjitha në objekte dhe vende publike, pra veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) i LZP-së e cila përcakton *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve, në apo mbi rrugë publike si dhe brenda ose jasht ndërtesave publike ose godinave”*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posterët e kandidatës për deputete nga koalicioni LDK-AKR, janë vendosur në hapësirë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë i datës 10.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, prandaj shkeljen zgjedhore vazhdimisht e kanë përsëritur si dhe faktin se posterat e kandidatit për deputet nga ky koalicion janë vendosur në objekte dhe vende të ndryshme publike. Paneli e urdhëroi koalicionin LDK-AKR, për ta përmirësuar shkeljen e bërë të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, brenda afatit të caktuar, ku i njëjti ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendet ku ka ndodhur shkelja, të cilat veprime kanë ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.180/2017 më datën 10.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118.4 të LZP-së.*